



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER MULI Y. MALLKUÇI  
ADRESA NR.5, VASO PASHA, NR.13/1  
TEL: 692020292

# REDAKTIM DHE VËRTETIM I AKTEVE TË SH.P.K-VE

Nr. repertori: 1118

Nr. koleksioni: 476

Tirane më 24/06/2022

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2022050370057889968



**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUT  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**"Immigration Services IBA" SH.P.K"**

Sot, më datë 24 Qershor 2022, para meje Noter MULI Y. MALLKUÇI, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.5, VASO PASHA, NR.13/1, u paraqit personalisht:

**THEMELUESIT:**

1. **Irma Floku**, atësia Thoma, amësia Maria, shtetase Shqiptare, lindur në Gjirokaster dhe banuese në Gjirokastër, me adresë L Punetore; Gjirokastër; 0000; Gjirokastër, lindur më 07/04/1973, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 037895593 dhe nr. personal H35407087S , .

2. **Ardian Seferi**, atësia Ndrec, amësia Naire, shtetas Shqiptar, lindur në Puke dhe banues në Gjirokastër, me adresë Punetore; Nd. 006; Gjirokastër; Gjirokastër; 6001; Gjirokastër, lindur më 10/12/1971, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 027238842 dhe nr. personal H11210123S , .

3. **Blerta Pelinku**, shtetase Italiane, lindur në Shkoder dhe banuese në Shkoder, me adresë Itali, lindur më 13/05/1979,, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim italian me nr. 513266 dhe nr. personal CA78560GY .

Ne baze e ne zbatim te ligjit:

- Nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" me poshte referohet si "Ligji Per Shoqerite";
- Nr.7512 date 10.08.1991 " Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire dhe te veprimtarise private dhe privatizimit";
- Nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" **Veprimtaria e shoqerise Immigration Services IBA sh.p.k.**

**do te organizohet dhe do te drejtohet sipas ketij Statuti te trajtuar ne te njejten dokument me Aktin e Themelimit.**

**PJESA E PARE  
DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

**Neni 1  
Ortaket**

1.1 Ortaket e shoqerise jane :



A2022050370057889968

1. Irma Floku, atësia Thoma, amësia Maria, shtetase Shqiptare, lindur në Gjirokaster dhe banuese në Gjirokastër, me adresë L Punetore; Gjirokastër; 0000; Gjirokastër, lindur më 07/04/1973, gjendja civile "beqare" madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 037895593 dhe nr. personal H35407087S.
2. Ardian Seferi, atësia Ndreç, amësia Naire, shtetas Shqiptar, lindur në Puke dhe banues në Gjirokastër, me adresë Punetore; Nd. 006; Gjirokastër; Gjirokastër; 6001; Gjirokastër, lindur më 10/12/1971, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Pasaporte Biometrike nr. BE0776597 dhe nr. personal H11210123S.
3. Blerta Pelinku, shtetase Italiane, lindur në Shkoder dhe banuese në Shkoder, me adresë Itali, lindur më 13/05/1979,, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim italian me nr. 513266 dhe nr. personal CA78560GY.

## Neni 2

### Emri

Emri i shoqërisë është **Immigration Services IBA** (më poshtë referuar si "Shoqëria").

## Neni 3

### Selia e Shoqerise

- 3.1 Selia e Shoqerise eshte ne adresen: Shqiperi, Tiranë, Rruga "Artan Lenja", Kompleksi Magnet, Ndertesa Dorado, Njesi Sherbimi 1107, Njesia adm nr.7.

Adrese elektronike: floku.irma@libero.it  
Telefon: +39 339 751 5392

- 3.2 Shoqëria mund te hapë degë, zyra përfaqësimi brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe atij te huaj ne fuqi.

## Neni 4

### Forma ligjore

- 4.1. Shoqëria është shoqëri shqiptare dhe është krijuar si **shoqëri me përgjegjësi të kufizuar**.

## Neni 5

### Kohëzgjatja

- 5.1. Shoqëria do te ushtroje aktivitetin e saj tregtar per nje periudhe te pacaktuar (pakufizuar).

## Neni 6

### Objekti i aktivitetit

Objekti i veprimtarise se shoqerise **Immigration Services IBA**, konsiston ne:

*Negocim, ndërmjetësim, kërkim-studim tregu, kosulencë mbi tregun e punes punesimin dhe rekrutimin e stafit per shoqeri brenda dhe jashte vendit, konsulence legale ne fushen e migrimit dhe emigrimit.*



A2022050370057889968

**PJESA II**  
**KAPITALI I SHOQËRISË DHE KUOTAT**



**Neni 7**  
**Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali i shoqërisë është 10,000(dhjetë mijë) Leke i marre persiper dhe i nenshkruar nga ortakët e saj.

Kapitali themeltar është i ndare ne 3 (tre) kuota , te cilat zoterohen nga ortakët si me poshte :

Ortaku	Kuotat e Nenshkruara	Vlera ne Leke	Perqindja(%)
Irma Floku	1	4000	40%
Blerta Pelinku	1	3000	30%
Ardian Seferi	1	3000	30%
<b>Total</b>	<b>3</b>	<b>10,000</b>	<b>100%</b>

Kapitali themeltar është vetem ne monedhen vendase, ne lekë.

Kapitali i nenshkruar do te derdhet ne llogarite bankare te shoqërisë nga ortakët jo me vone se 60 dite nga themelimi i shoqërisë dhe jo me vone se 50 dite nga regjistrimi i saj ne regjistrin tregetar.

**III. STRUKTURA DREJTUESE**  
**TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKUT/ORTAKEVE**

**Neni 8**  
**Përgjegjësia e kufizuar**

8.1. Ortakët jane përgjegjës deri në vlerën e pjesës së tyre në kapitalin e Shoqërisë. Shoqëria është përgjegjëse për detyrimet e saj me të gjitha asetet.

**Neni 9**  
**Të drejtat e lidhura me cdo kuotë**

9.1. Cdo kuote e secilit ortak do t'i përgjigjet një vote korrensponduese në mbledhjet e ortakëve ne perpjestim me % qe ka kuota e tij ne raport me kapitalin dhe do t'i japë ortakëve të drejtën për të marrë dividendë në rast shpërndarje të fitimit si dhe të drejtën e pjesës përkatëse që mbetet pas procedurave të likuidimit në rast prishje apo likuidimi të Shoqërisë.

**Neni 10**  
**Fitimi dhe kalimi i kuotave**



- 10.1. Kuotat e kapitalit te shoqerise fitohen apo kalohen nepermjet:
- kontibutin ne kapitalin e shoqerise;
  - shitblerjes;
  - trashegimise
  - dhurimit
  - cdo menyre tjeter parashikuar me ligj.
- 10.2. Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata do behet me shkrim.

### **Neni 11 Detyrimet e Ortakëve**

11.1 Ortakët kanë detyrim të paguajnë pjesën e tyre, të marrin pjesë në mbledhjet e asamblesë nëse fitohen-njoftohen në mënyrën e duhur, të mbështesin Shoqërinë në kryerjen e veprimeve të saj si dhe të përmbushin vendimet e mbledhjes së ortakëve dhe organeve të tjera të Shoqërisë të cilat janë marrë në mënyrën e duhur brenda qëllimit të organit përkatës.

### **PJESA IV ASAMBLEJA E PERGJITHSHME**

#### **Neni 12 Të drejtat e asamblesë së pergjithshme**

- 12.1 Asambleja e pergjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë e cila ka të drejtë të marrë vendime në lidhje me të gjitha çështjet e veprimtarisë së saj.
- 12.2 Asambleja e pergjithshme përbëhet nga të gjithë ortakët zoterues te kuotave.
- 12.3 Vetëm asambleja e pergjithshme ka të drejtë të vendosë për sa më poshtë:
- ndryshime dhe modifikime të Statutit;
  - pranimin e ortakëve të rinj (pas rritjes së kapitalit apo transferimit të kuotave);
  - zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit dhe/ose cdo lloj pagimi të pjesshëm ose subvencionit të dhënë nga ortakët;
  - bashkimin, ndarjen, prishjen dhe cdo lloj transformimi të Shoqërisë;
  - blerjen apo disponimin e interesit pjesëmarrës në shoqëri shqiptare apo të huaja;
  - hapjen dhe mbylljen e degëve dhe zyra e përfaqësimit jashtë vendit;
  - pjesetimin dhe anulimin e kuotave;
  - perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
  - miratimin e raporteve vjetore dhe bilancit të shoqërisë si dhe shpërndarjen e fitimit;
  - blerjen, shitjen dhe dhënien peng të pasurive të paluajtshme;
  - të vendosë për investimet;
  - të japë letra me vlerë, të marrë detyrime, të lëshojë garanci ose letra sigurie
  - të përcaktojë parimet e pergjithshme të politikave të shoqërisë;
  - të caktojë shpërblimet për administratorët, të përfundojë kontratat e punës me administratorët dhe nëpunësit ekzekutivë të shoqërisë;
  - të japë alternativa, të drejta të ndarjes së fitimit vjetor, pagesave në natyrë, të drejtat mbi pensionet ose cdo pagese mbi largimin e drejtorëve, dhe nëpunësve ekzekutivë të shoqërisë;



A2022050370057889968

- (p) emerimin dhe shkarkimin e likujduesve, ekspertëve kontabël te autorizuar;
- (q) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- (r) percaktimin e shperblimeve per likujduesit, ekspertet kontabel;
- (s) mbikqyerjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret;
- (t) miratimin e rregullave të brendshme mbi administrimin dhe mbledhjes se asamblese;
- (u) percaktimin e strukturës organizative dhe administrative të Shoqërisë;
- (v) percaktimin e buxhetit vjetor;
- (w) miratimin e cdo cështje tjetër zgjidhja e së cilës i është rezervuar asamblesë së pergjithshme në përputhje me ligjin dhe këtë Statut.
- (x) Marrjen e huave ne emer të shoqerise dhe vendosjen e kushteve te huase
- (aa) Lidhjen e mareveshjeve per dhenien e huave

12.4 Asambleja e pergjithshme do të ketë të drejtë të vendosë mbi cdo cështje që tejkalon aktivitetin e përditshëm të shoqërisë.

### Neni 13

#### Vendimet e asamblesë së pergjithshme

13.1 Vendimet e renditura përse i përket ndryshimit të statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë merren me  $\frac{3}{4}$  (tre te katertat) e votave të ortakëve pjesëmarrës.

### Neni 14

#### Thirrja e asamblesë së pergjithshme

14.1 Asambleja e pergjithshme do të thirret nga administratorët të paktën njëherë në vit në selinë e Shoqërisë ose ne cdo vend tjetër nëse percaktohet ne njoftim.

14.2 Gjithashtu, ortakët të cilet perfaqësojnë të paktën 20 për qind të totalit të votave ne asamblenë e pergjithshme të shoqërisë mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim ose nëpërmjet postës elektronike për të thirrur asamblenë e pergjithshme. Në kërkesën drejtuar administratorëve mund të përfshihen dhe cështjet e posacme të rendit të ditës. Pas marrjes se kerkeses, jo me vone se 15 dite, administratori eshte i detyruar te njoftoje thirrjen e asamblese.

14.3 Asambleja e pergjithshme do të thirret me anë të një njoftimi të shkruar të dërguar nga administratorët, njoftim ky i cili duhet të merret nga përfaqësuesit e ortakëve nëpërmjet një letre rekomande, email, telexi apo faksi jo më pak se 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar të mbledhjes. Njoftimi i shkruar do të regjistrohet në librin e procesverbalit të shoqërisë. Gjithashtu, asambleja e pergjithshme mund të thirret nëpërmjet postës elektronike me të njëjtat kushte dhe afate.

14.4 Njoftimi për takimin e asamblesë së pergjithshme do të tregojë datën kohën dhe vendin e takimit si dhe cështjet e rendit të ditës.

14.5 Nëse data për mbledhjen e ardhshme të asamblesë është vendosur në takimin e fundit dhe të gjithë ortakët kanë qënë prezentë, atëherë do të gjykohet sikur njoftimi është dërguar.



A2022050370057889968

- 14.6 Nëse të gjithë ortakët janë prezentë në asamblenë e ortakëve, atëherë vendimet mund të merren dhe në mungesë të përmbushjes së kërkesave formale të caktuara më sipër nëse të gjithë ortakët janë dakord.

### Neni 15

#### Vendimet e marra në asamblenë e përgjithshme

- 15.1 Vendimet në asamblenë e përgjithshme të cilat kërkojnë një shumicë të zakonshme mund të merren vetëm nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave. Vendimet në asamblesë e përgjithshme të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar mund të merren vetëm nëse janë të pranishëm ortakët të cilët zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave.
- 15.2 Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
- 15.3 Cdo ortak ka të drejtë të thërrasë këshilltarë në mbledhjen e asamblese, të cilët do të jenë të detyruar të ruajnë fshehtësinë e mbledhjes.
- 15.4 Nëse mbledhja e asamblese se përgjithshme thirret në mënyrë të rregullt por nuk plotësohet numri i ortakëve të caktuar për të përmbushur kuorumin, atëherë asambleja do të thirret përsëri në përputhje me Nenin 14 dhe gjithmonë jo më vonë se 30 ditë me të njëjtin rend dite.
- 15.5 Nëse edhe pas thirrjes sipas pikës 15.4 të Nenit 15 nuk harriet pjesëmarrja sipas pikës 15.1 të këtij Neni, atëherë asambleja do të thirret përsëri, në përputhje me pikën 15.4 të Nenin 15. Në këtë rast, vendimet do të miratohen me shumicë të thjeshtë apo të kualifikuar (sipas objektit të çështjes) të pjesëmarrësve në asamble.
- 15.6 Ortaket kanë të drejtë të përfaqësohen dhe të përfaqësojnë në asamblenë e përgjithshme nepermjet prokurave të posacme të cilat duhet të depozitohen në sekretarinë e shoqërisë 48 ore përpara datës së mbajtjes së mbledhjes.

### Neni 16

#### Drejtimi i mbledhjes së asamblese se përgjithshme

- 16.1 Kryetari i mbledhjes së asamblese se përgjithshme do të caktohet nga ortakët.
- 16.2 Do të aprovohen apo refuzohen vetëm ato çështje të cilat janë përcaktuar shprehimisht në rendin e ditës për mbledhjen e asamblese. Diskutimet mbi çështje të ndryshme nga ato të rendit të ditës mund të bëhen vetëm nëse të gjithë ortakët japin pëlqimin e tyre.

### Neni 17

#### Procesverbali i mbledhjes së asamblese se përgjithshme

- 17.1 Për cdo mbledhje të asamblese se përgjithshme do të mbahet një procesverbal dhe do të merren vendime. Procesverbali duhet të mbajë datën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe të mbajtësit të procesverbalit dhe rezultatet e votimit. Një kopje e procesverbalit do të përgatitet për Shoqërinë, një për regjistrin tregëtar dhe një për secilin ortak. Procesverbalit i bashkangjitet edhe lista e pjesëmarrësve së bashku me aktin e thirrjes së asamblesë së përgjithshme.



- 17.2 Procesverbali do të firmoset nga kryetari dhe nga mbajtesi i procesverbalit.
- 17.3 Kopjet e vendimeve përkatëse të ortakëve do t'u dërgohen ortakëve me letër rekomande jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas takimit të ortakëve. Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, një kopje e procesverbalit do të publikohet jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes në këtë faqe.
- 17.4 Administratori është përgjegjës për ruajtjen e kopjeve të procesverbalit dhe shpërndarjen e tij.

**PJESA V**  
**ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

**Neni 18**  
**Administrimi i Shoqërisë**

- 18.1 Administrimi i shoqërisë do të bëhet nga nje ose me shume administratore, te cilet do te përfaqësojnë Shoqërinë se bashu ose vec e vec. Gjithashtu, asambleja e pergjithshme mund të caktojë kompetenca përfaqësimi individuale secilit prej administratorëve.
- 18.2 Administratorët mund të autorizojnë palë të treta që t'i përfaqësojnë ata në transaksione dhe/apo ceshtje të vecanta.
- 18.3 Administratorët do të organizojnë dhe menaxhojnë të gjithë aktivitetin e Shoqërisë. Ata janë të autorizuar të përfaqësojnë Shoqërinë në të gjitha çështjet që kanë lidhje me të vec e vec ose se bashku.
- 18.4 Të drejtat dhe detyrimet e administratorëve burojnë nga ligji, ky Statut, vendimet e Asamblese se Pergjithshme dhe rregullat e brendshme të administrimit të Shoqërisë.
- 18.5 Administratorët kanë të drejtat e mëposhtme:
- (a) përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt palëve të treta dhe shtetit;
  - (b) hapjen e llogarive bankare të Shoqërisë ne bankat e nivelit te dyte, si dhe marrjen e kredencialeve dhe per perdorimin e sherbimeve on-line si e-banking dhe te tjera me te njejta te drejta - detyrime dhe kufizime sikur keto sherbime do te kryeshin ne sportelet fizike te bankave.
  - (c) përfundimin e marrëveshjeve me palët e treta, lëshimin dhe marrjen e urdhër pagesave;
  - (d) nënshkrimin e të gjithë dokumentave, nxjerrjen e faturave, transferimet në monedhë të huaj, fletë ngarkesat etj, pagimin e detyrimeve të Shoqërisë dhe pranimin e letrave me vlerë nga palët e treta;
  - (e) mbledhjen e detyrimeve që i takojnë shoqërisë, dhënien dhe marrjen e paradhënies;
  - (f) dhënien e moratoriumit debitorëve të Shoqërisë, heqjen dorë nga paditë që vijnë si pasojë e marrëdhënies të Shoqërisë me palët e treta dhe/ose pranimin e këtyre padive;
  - (g) punësimin dhe shkarkimin e stafit të Shoqërisë, përcaktimin e pagave, shpërblimeve dhe pagesave të stafit;
  - (h) marrjen e masave paraprake për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë, fillimin e padive dhe marrjen përsipër të mbrojtjes së Shoqërisë në rast të padive kundër saj;





A2022050370057889968

administratorët mund të udhëzojnë avokatët të mbrojnë Shoqërinë dhe mund të përcaktojnë shumën e shpërblimit të tyre; administratorët kanë të drejtë të ngrenë padi dhe t'i tërheqin ato, të nënshkruajnë marrëveshje gjyqësore, të mbyllin marrëveshje arbitrazhi, të caktojnë arbitra, të tërheqin paditë e ngritura nga Shoqëria dhe të ndërprejnë procedimet;

- (i) administratorët kanë të drejtë marrin cdo vendim tjetër që i takon aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë nga pikëpamja e ligjit dhe këtij Statuti;
- (j) mbledhjen e shpenzimeve të Shoqërisë;
- (k) administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e llogarive në përputhje me ligjin dhe parimet e ligjit;
- (l) administratorët janë përgjegjës për përgatitjen dhe nënshkrimin e bilancit vjetor dhe pasqyrave vjetore financiare të Shoqërisë dhe kontrollin e tyre nga një auditor i jashtëm nëse dicka e tillë kërkohet nga ligji apo vendimi i mbledhjes së ortakëve;
- (m) thirrjen e mbledhjeve të ortakëve; përcaktimin e rendit të ditës; monitorimin e përmbushjes së dispozitave që kanë lidhje me thirrjen dhe drejtimin e mbledhjes së ortakëve për shpalljen e vendimeve të vecanta;
- (n) publikimin e shpalljeve të nevojshme përfshirë dhe publikimin e pasqyrave vjetore financiare;
- (o) administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e rregullt dhe ruajtjen e dokumentacionit të Shoqërisë;
- (p) ndryshimin e te dhenave të kontaktit të shoqërisë;
- (q) hapjen dhe mbylljen e selive të adresave sekondare të ushtrimit të aktivitetit brenda territorit të Shqipërisë.
- (r) marrin vendime mbi të gjitha çështjet e tjera që lidhen me aktivitetin e brendshëm të Shoqërisë dhe marrëdhëniet e saj të jashtme.
- (s) Administratorët, secili vec e vec, ose se bashku, kanë të drejtë dhe kompetencë të autorizojnë punonjësit e shoqërisë dhe/apo punonjes të palë të treta të personave juridike apo fizike që t'i përfaqësojnë ata dhe shoqërinë në transaksione ekonomike-financiare-juridike për të cilat nuk ka kufizim në Statut, në legjislacionin Tregëtar dhe atë Civil.

18.6. Personat e identifikuar si më poshtë do të caktohet administratore të shoqërisë për një periudhë 5 (pesë) vjecare me të drejtë ripërtëritjeje:


1. **Irma Floku**, atësia Thoma, amësia Maria, shtetase Shqiptare, lindur në Gjirokaster dhe banuese në Gjirokastër, me adresë L Punetore; Gjirokastër; 0000; Gjirokastër, lindur më 07/04/1973, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 037895593 dhe nr. personal H35407087S.
2. **Toni Papandoni**, atësia Avni, amësia Eli, shtetas Shqiptar, lindur në Sarandë dhe banues në adresën Njesia Nr.3 B.Curri; Nd. 490; H. 1; Ap. 1; Njësia Administrative Nr. 3; Tiranë; 0000; Tiranë, i datëlindjes 28/03/1969, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035736421 dhe nr. personal G90328079J.

Te cilet veprojnë të dy se bashku ose vec e vec me të njëjtat kompetenca.

**PJESA VI**  
**VITI FINANCIAR, PASQYRAT FINANCIARE, FITIMI DHE HUMBJET**



A2022050370057889968



### Neni 19

#### Viti financiar, pasqyrat vjetore financiare

- 19.1 Viti financiar i Shoqërisë zgjat 12 muaj dhe fillon në ditën e parë të Janarit dhe mbaron në ditën e tridhjetë e një të Dhjetorit. Viti i parë financiar i Shoqërisë fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë dhe mbaron në datën e tridhjetë e një-të të Dhjetorit të vitit të regjistrimit.
- 19.2 Në fund të çdo viti financiar, administratorët do të përmbushin detyrat e mëposhtme:
- (a) përgatitjen e një liste të detajuar të aseteve të Shoqërisë dhe strukturës së tyre;
  - (b) përgatitjen e pasqyrave financiare të shoqërisë i cili përshkruan situatën financiare të Shoqërisë;
  - (c) përgatitjen e llogarive të fitimit dhe të humbjeve.
- 19.3 Pasqyrat financiare të përgatitura do të paraqiten në mbledhjen e zakonshme të asamblesë së ortakëve për miratim, së bashku me një raport të auditorëve të jashtëm (nese është e detyrueshme nga legjislacioni apo kerkuar nga asambleja).

### Neni 20

#### Fitimi i Shoqërie

- 20.1 Fitimi neto i Shoqërisë do të shpërndahet në përputhje me pjesët e kapitalit në Shoqëri.
- 20.2 Fitimi neto do të jetë fitimi i Shoqërisë në përputhje me pasqyrat vjetore financiare të miratuara pas zbritjes së të gjitha taksave dhe caktimit të rezervave ligjore. Hartimi i Pasqyrave Financiare të shoqërisë dhe dorezimi i tyre pranë autoriteteve shtetërore do të bëhet sipas legjislacionit në fuqi për kontabilitetin, gjegjësisht legjislacionit fiskal dhe atij tregëtar.

## PJESA VII PRISHJA DHE LIKUIDIMI

### Neni 21

#### Prishja dhe likuidimi

- 21.1 Shoqëria do të zgjidhet në rastet e mëposhtme:
- (a) vendim i mbledhjes së asamblesë së ortakëve;
  - (b) bashkimi me një shoqëri tjetër;
  - (c) vendimi i gjykatës me juridiksion përkatës në rastet e parashikuara me ligj;
  - (d) në të gjitha rastet e tjera të parashikuara me ligj.
- 21.2 Likuidimi i Shoqërisë dhe shpërndarja e aseteve të Shoqërisë do të bëhet në përputhje me dispozitat ligjore.

## PJESA VIII TE PERGJITHSHME



A2022050370057889968

## Neni 22 Te pergjithshme

- 22.1 Në rast mosmarrëveshjes të eilat linden si pasojë e këtij Statuti ose për shkak të ligjit, ortakët do të përpqen t'i zgjidhin ato miqësisht. Nëse nuk arrihet një marrëveshje, mosmarrëveshja e ortakëve do të zgjidhet nga gjykata me juridiksion përkatës.

### POZITAT PËRFUNDIMTARE

Unë Noteri verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 e vijues të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

### THEMELUESIT

Irma Floku

Blerta Pelinku

Ardian Seferi

### NOTER

MULI Y. MALLKUÇI